

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

**31.07.2024
Ora 10:34**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 24, datë 05.05.2023 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• **Stafi KQZ Znj.M.Çelmeta, znj.M.Koja, z.E.Meta.**

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditë e sotme në orën 10.30. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. E pranishme Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës, gjithashtu dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në mbledhjen e sotme kemi një projektvendim për të shqyrtuar, pra një

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

çështje në rendin e ditës. Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 24, datë 5.05.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit doja të pyesja kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të trajtuar dhe nëse do të kenë, do t’ju lutesha që t’i trajtonim pas shqyrtimit të projektvendimit, pra në fund. Kolegë ka diçka jashtë rendit të ditës? Zoti Çakaj për...

Z. M. Çakaj: Në fakt unë vetëm një pyetje kisha...

Znj. I. Nano: Dakord!

Z. M. Çakaj: ...që mund ta drejtojmë edhe tani pa nisur shqyrtimi. Pyetja ime ka lidhje me kërkesën që kemi bërë para disa ditësh për administratën e KQZ-së, lidhur me konstatimin e raportit të auditimit teknicien, mbi 311 zgjedhës të shtuar, nga viti 2023 në vitin 2024, në Bashkinë Himarë. Kemi ndonjë përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile lidhur me këtë rast?

Znj. M. Çelmeta: Përgjigje nuk kemi ende, jemi në pritje. Besoj se për dy-tre ditë duhet të vijë.

Znj. I. Nano: Dje është dërguar shkresa apo jo?

Znj. M. Çelmeta: Shkresa është dërguar me datë 29.

Znj. I. Nano: Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Z. M. Çakaj: Ende s'është kthyer përgjigje?

Znj. M. Çelmeta: Kështu që jemi në pritje. Po.

Z. M. Çakaj: Dakord, faleminderit!

Znj. M. Çelmeta: Faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord! Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në vazhdën e pyetjeve dhe në kuadër të detyrave që lamë: a ju dërgua Kontrollit të Lartë të Shtetit raporti teknikien?

Znj. M. Çelmeta: Me sa kam informacion, jo.

Znj. H. Vukaj: Ende jo?

Znj. M. Çelmeta: Ende jo.

Znj. H. Vukaj: A ju duket normale?

Znj. M. Çelmeta: Mbase nga ngarkesa e punës e kemi...

Znj. H. Vukaj: Ngarkesën po, e kemi të qartë, por ju lutem brenda ditës së sotme të dërgohet urgjent!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Znj. M. Çelmeta: Po, patjetër.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Çështje jashtë rendit të ditës nuk kemi. Fillojmë atëherë me shqyrtimin e projektvendimit. Është një ndryshim në projektvendimin e Komisionit Rregullator nr. 24, datë 5.05.2023. Kush nga administrata do të prezantojë shkurtimisht ndryshimet e paraqitura? Zonja Çelmeta!

Znj. M. Çelmeta: Do të jem unë.

Znj. I. Nano: Faleminderit!

Znj. M. Çelmeta: Atëherë, e nderuar zonja Nano! Të nderuar anëtarë të Komisionit! Me vendimin nr. 24, të vitit 2023, është miratuar “Udhëzuesi i punës për KZAZ-të dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Duke qenë se ky udhëzues i referohet vetëm zgjedhjeve të rregullta, periodike dhe nuk trajton rastet e zgjedhjeve të pjesshme për secilën prej organeve të qeverisjes vendore, respektivisht kryetarin apo këshillin e bashkisë, propozohet që të detajohen procedurat për secilën prej këtyre proceseve zgjedhore. Ndryshimet e propozuara në pikat 1/1 dhe 1/2 të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 24, datë 5.05.2023 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, kanë për qëllim të detajojnë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për këshillin e bashkisë dhe për kryetarin e bashkisë. Këta udhëzues ju vijnë në ndihmë edhe trajnerëve të administratës zgjedhore për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

zhvillimin e trajnimeve për Grupet e Numërimit të Votave. Për sa më lart në këtë relacion, administrata e KQZ-së, nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në respektim të detyrave dhe afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim, Komisionit Rregullator, projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 24, datë 5.05.2023 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Çelmeta! Fillojmë me diskutimin në parim të projektvendimit. Kolegë, kush dëshiron të marrë fjalën? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Unë kam disa pyetje për administratën, meqë... Ndoshta drejtori që mbulon pjesën respektive do të jetë më kompetenti në këtë rend pyetjesh. Zoti Meta, lidhur me këtë projektakt do të doja të dija nëse keni pasqyruar në këtë projektakt, ato çfarë keni konstatuar se kanë çaluar nga Grupet e Numërimit si elementë risku apo neglizhencë, nga ato që thuhet në raport, apo veprimtari ndryshe nga ato që thuhet... Më falni, në aktet udhëzuese? Pyetja e parë kjo.

Z. E. Meta: Projektakti adreson të gjitha, si të thuash, praktikat e deritanishme bazuar dhe në vendimin në fuqi, vendimin 24 dhe nuk sjell ndryshime të mëtejshme nga vendimi 24 që është miratuar nga ana juaj.

Znj. H. Vukaj: Po cila është risia e këtij projekti?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Z. E. Meta: Siç u shpjegua dhe në relacion, risia qëndron në proceset zgjedhore të pjesshme, siç janë zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie apo zgjedhjet e pjesshme për këshillin e bashkisë. Duke qenë se vendimi në fuqi është një vendim që trajton procedurat integrale, pra për procese periodike. Në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie apo në zgjedhjet e pjesshme, për potenciale, le të themi për këshillin e bashkisë, procedurat janë paksa më të thjeshtëzuara në krahasim me procedurat, më falni, kur votohet për të dyja organet e qeverisjeve vendore.

Znj. H. Vukaj: A keni pasqyruar...

Z. E. Meta: Pra, le të themi...

Znj. H. Vukaj: Po.

Z. E. Meta: ... për organet e qeverisjes vendore kemi dy kuti votimi...

Znj. H. Vukaj: Po.

Z. E. Meta: ...njëra për kryetarin e bashkisë dhe tjetra është për këshillin e bashkisë, ndërsa në zgjedhjet e pjesshme, kemi vetëm një kuti votimi, në rastin konkret për zgjedhjet e Bashkisë Himarë. Le të themi zgjedhjet e pjesshme janë vetëm për kryetarin e bashkisë, në rast se do të ketë zgjedhje të pjesshme për këshillin e bashkisë, le të themi, do të jetë po prapë një kuti votimi dhe rrjedhimisht edhe procedura për procedurën e numërimit të votave, apo dhe tabulimin e rezultateve kanë ndryshime të lehta, le të themi përse i përket procesit të punës, nga grupet e numërimit të votave dhe nga KZAZ-ja.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Meqenëse ky akt u ridraftua ose patët edhe njëherë kohën ta ripunonit, a përfshitë në këtë akt, në këtë draftakt edhe konstatimet e gjetura më herët nga kolegu Dritan Çaka?

Z. E. Meta: Po, janë reflektuar.

Znj. H. Vukaj: Po në cilat pjesë?

Z. E. Meta: Në lidhjen 2/2 dhe lidhjen 3.

Znj. H. Vukaj: Në çfarë konsistojnë?

Z. E. Meta: Në lidhjen 2 dhe lidhjen 3.

Znj. H. Vukaj: Ku konsistojnë?

Z. E. Meta: Ishte për votat gabim..

Znj. I. Nano: Të hedhura gabim.

Znj. H. Vukaj: Nuk është pyetje por është konstatim tek... Mbas vendimit, tek lidhja 3, në faqen 3, kur ju rendisni elementët që një votë ose një fletë votimi e bëjnë të pavlefshme, unë kam konstatuar që, në kuadër edhe të atij rriskut që e ndeshim në çdo palë zgjedhje, të fenomenit “tren” ose njihet në terminologjinë mediatike me terma të ndryshëm “el çapo” apo fleta e parë, dalja e fletës së parë. Unë konstatoj që mungon edhe tekstura e letrës, pra unë preferoj që... Jo preferoj, por do të propozoj

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

kolegëve që të shtohet edhe tekstura e letrës, në faqen 3, në krye të vazhdës së cilësive të renditura të... Për të konstatuar...

Z. E. Meta: Më lini t'ju shpjegoj që udhëzuesi i punës bazohet te vendimi 23, i vitit 2023 i Komisionit Rregullator, për rregullat dhe rrjedhimisht nuk mund të tejkalojë parashikimet që janë parashikuar te ky vendim.

Znj. I. Nano: Ne atë jemi duke ndryshuar, kështu që në qoftë se ka vend, ato që ne i kemi si specifikime teknike të fletës së... Po, po zonja Koja!

Znj. M. Koja: Mund të sjell në vëmendje diçka. Pra, kemi dy vendime të Komisionit Rregullator, është vendimi 23 i vitit 2023, i cili përcakton rregullat e punës të GNV-së dhe KZAZ-së në qasje me numërimin dhe vlerësimin e votave dhe nxjerrjen e rezultatit. Dhe në zbatim të këtij vendimi ne nxjerrim një udhëzues, pra Rregullatori miraton një udhëzues, i cili është një dokument pune më i thjeshtuar, më lehtësues për anëtarët. Çfarë parashikohet në thelb, përsa i përket kategorizimit “votë e vlefshme” apo “e pavlefshme” është e parashikuar në vendimin 23. Nëse do të duam të bëjmë një përmirësim në këtë vendim, atëherë është e udhës që të bëjmë të njëjtën gjë dhe te vendimi 23, pikë së pari dhe më pas të vijmë tek “Udhëzuesi...” me ndryshimin që duhet reflektuar fillimisht te vendimi Rregullator dhe më pas tek “Udhëzuesi...”.

Znj. H. Vukaj: Kjo nuk ndryshon në qoftë se ne të gjithë kemi dakordësinë që ky është një element esencial. Ne mund ta shtojmë këtu dhe ndryshojmë aktin sepse në moment që ne jemi të gjithë dakord për këtë lloj elementi, e ndryshojmë aktin në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

kushtet e dakordësisë edhe pas këtij akti. Nëse kolegët bien dakord, unë e sjell si propozim.

Znj. I. Nano: Duhet gjetur propozimi apo fjala e saktë, se ndoshta fjala teksturë nuk shkon, duhet gjetur konkretisht...

Znj. H. Vukaj: Teksturë më vjen në moment, por ideja është që në kushtet e teknikës adapte apo teknikienët e administratës mund të na propozojnë një fjalë të përshtatshme e cila i shkon.

Znj. M. Koja: Ndoshta i referohemi vendimit “Për karakteristikat teknike të zbatimit...”

Znj. I. Nano: Teknike të fletës...

Znj. M. Koja: ... dhe terminologjia që është përdorur në atë vendim që ju keni miratuar më herët.

Znj. H. Vukaj: Dakord, orientohe mi bazën e atij vendimi dhe gjejmë fjalën e përshtatshme dhe mbasi ne ta votojmë dhe ta përfshijmë, të përçojmë ndryshime edhe te ai akt. Faleminderit!

Znj. I. Nano: I bëjmë.. Po.

Znj. M. Koja: Edhe një pyetje, ju lutem zonja Vukaj! Atëherë ky ndryshim do jetë në lidhjen 2 dhe në lidhjen 3 ? Sepse do t'i reflektojë të dyja.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Në momentin që ne konstatojmë njëherë...

Znj. M. Koja: 1, 2, 3, në të treja lidhjet.

Znj. H. Vukaj:... automatikisht do të përfshihet në të gjitha lidhjet. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord! Në parim nuk kemi diçka tjetër besoj. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord ?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë pikë për pikë. Atëherë me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Në vendimin nr. 24, datë 5.05.2023, bëhen këto ndryshime:

1. "Pika 1 ndryshon si më poshtë:

"Miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupeve e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në lidhjen 1, kemi propozimin e zonjës Vukaj.

Znj. I. Nano: Po

Znj. H. Vukaj: Po, patjetër.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Znj. M. Koja: Atëherë në lidhjen 3 dhe në faqen 3 të saj kemi këtë parashikim “Konsiderohet votë e pavlefshme fleta e votimit që nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja” dhe këtu mendoj që mund të ndërhyjmë të themi “formë dhe karakteristika teknike të miratuara”. Dakord?

Znj. H. Vukaj: “Karakteristika teknike të miratuara”, mund të vendosim një futnotë ose një... Ai numëruesi në qendrën e numërimit ta ketë parasysh, sepse ndoshta i referohet atyre barkodeve, i referohet ca detajeve në fletë, por jo përmbajtjes...Pra, të fusim një futnotë e cila sqaron karakteristikat.

Znj. M. Koja: Sepse e kemi “madhësinë, ngjyrën, formën”.

Znj. H. Vukaj: Po pra, po. Po të jetë më e përshtatshme për t’u kuptuar lehtësisht nga numëruesit në tavolinë.

Znj. M. Koja: Dakord.

Znj. H. Vukaj: Ose një futnotë ose në kllapa përmbajtja e letrës, përbërja ose përmbajtja.

Znj. M. Koja: Siç është miratuar atëherë. Ka disa karakteristika ajo..

Znj. H. Vukaj: Po.

Znj. M. Koja: ...thurje kaq, ka një përqindje.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Dakord, por..

Znj. M. Koja: Këto janë, atëherë mund t'i përdorim nga vendimi.

Znj. H. Vukaj: ...tekstura vjen si fjalë e përshtatshme, për sa kohë është e huazuar le të gjejmë një fjalë shqip që i përmbahet.

Znj. M. Koja: Dakord! Në rregull. Këtu flasim për ndërhyrje, dakord!

Znj. H. Vukaj: Po, po. E gjejmë si fjalë teknike, më pas..

Znj. M. Koja: Konkretisht është ...

Znj. H. Vukaj: ...ideja është që është një element që duhet.

Znj. M. Koja: ...element shtesë. Po!

Znj. I. Nano: Dakord! Atëherë jemi te pika 1 dhe do të bëjmë ndryshimin e propozuar nga zonja Vukaj. Kolegë?

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet! Te lidhja 1 do të shtohet, miratohet lidhja 1 po do të shtohet edhe ky element.

Pika 2, pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Pika 1/1. Miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për Zgjedhjet e Pjesshme për Kryetar të Bashkisë sipas lidhjes 2, numër 2 që bashkëlidhet këtij vendimi.

Pika 1/2. Miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për Zgjedhjet e Pjesshme për Këshillin e Bashkisë sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Te të dy lidhjet do të shtojmë të njëjtën fjalë apo shprehje si dhe te lidhja 1.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj).

Kundër: s'ka!

Me 5 vota pro, miratohet!

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord ?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj).

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë, dakordësinë tuaj.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pas miratimit të këtij projektakti do t'ju lutesha administratës, veçanërisht Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, që për këto zgjedhje, që kemi në prag, të mundësojë shumëfishimin, trajnimin sa më shpejt që të jetë e mundur të anëtarëve të Grupeve të Numërimit.

Zgj. H. Vukaj: Edhe një herë, një kërkesë shtesë.

Zgj. I. Nano: Po, patjetër, si zakonisht zonja Vukaj ka dhe një gjë për të shtuar.

Zgj. H. Vukaj: Për sa kohë i shërben procesit, patjetër që do shtoj sa herë të nevojitet. Meqenëse në administratën me një Sekretar tjetër të Përgjithshëm, në zgjedhje të tjera kam ngritur alarmin e këtij fenomeni që unë parapërmenda, të fenomenit të daljes së fletës së parë të votimit. I kam lënë detyrë atij që t'i drejtohet organizatave partnere ndërkombëtare që merren me procesin zgjedhor apo ambasadave të akredituara këtu që të na ndihmojnë me gjetjen e një çelsi suksesi në vendet e tyre, për të paralizuar këtë fenomen në kuadrin e zhvillimit të zgjedhjeve të vitit 2025. Kështu që, ose OSBE/ODHIR-i është organizata e parë, për të tjerat rakordoni se cilët janë partnerët

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 31.07.2024*

tanë të volitshëm dhe që na kanë shërbyer në mbështetje dhe ide, edhe nisjani.
Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Dikush tjetër, ndonjë gjë për të shtuar? Jo? Meqenëse nuk kemi çështje të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 07

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

